



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Qytetërimi i gjuhës B (2)

Ngarkesa: 20 Seminare, 20 Leksione, 4 Kredite
Viti / Semestri: Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në rishprehjen në gjuhë të huaj të të gjitha të dhënave dhe materialeve me karakter historik mbi historinë e Qytetërimit turk, ku aktiviteti i tij mendojë në përpunimin e mendimit kritik në rrethanat historike dhe në zhvillimin e civilizimit të vendin kryesor. Shkathtësimi i të menduarit dhe të shprehurit në gjuhën e huaj mbi një bosht të përcaktuar ideor, formëson studentin në mbajtjen e një rendi logjik në ligjërimin e tij dhe në racionalitetin e përdorimit sa më të saktë të gjuhës greke. Përtej sa më sipër, studenti informohet me elementet e historisë së civilizimit përmes së cilave ka kaluar Turqia dhe se çfarë rezultatesh sollën këto elemente në popullin turk, në vendet fqinje e më gjerë. Kjo lëndë synon t'u japë studentëve njohuri historike mbi zhvillimet në shekullin 14-të dhe 16-të në Perandorinë Osmane

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte fillestare të historisë së qytetërimit turk.
2. Aftësi për të komunikuar në situata të ndryshme jo shumë të vështira.
3. Njohuri mbi fakte historike.
4. Aftësi për të treguar për gjëra mjaft të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime

Rezultatet e pritshme :

1. Rishprehje në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në gjuhë të huaj (turke ose greke, sipas fokusit të kursit) informacione dhe koncepte themelore mbi historinë e qytetërimit turk, veçanërisht në periudhën osmane (shek. XIV–XVI).
2. Zhvillojë mendim kritik dhe aftësi analitike për të interpretuar ngjarje historike dhe për të kuptuar ndikimin e tyre në kontekstin rajonal dhe më gjerë.
3. Komunikojë në mënyrë funksionale dhe bashkëpunuese, duke përdorur gjuhë të saktë dhe racionale për të ndërtuar ligjërim të qëndrueshëm mbi tema historike dhe kulturore.